

VENDIM
Nr. 830, datë 7.10.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “a”, të pikës 1/3, të vendimit nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet emërtesa “Agjencia e Zhvillimit të Territorit”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të fillojnë nga momenti i emërimit në detyrë të nëpunësve/punonjësve të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe, për vitin 2015, të përballohen nga fondet e miratuara për këtë institucion për vitin 2015.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama